



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:275939

Datë: 05.01.2024

Numri i dokumentit: 05158973

C.nr. 2825/21

GJYKATA THEMELORE PEJË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Besnik Shala, në çështjen juridike – kontestimore të paditësit I.D nga P, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Av. Sh.B nga P, kundër të paditurit S.L nga K-P, rr”...” nr....., me bazë juridike vërtetim pronësie, vlera e kontestit 5,000.00 euro, pas mbajtjes se seancës se shqyrtimit kryesor të dt. 28.12.2023, në prezencën e të autorizuarit te paditësit dhe ne prezencën e të të paditurit shpalli, ndërsa me dt. 05.01.2024, përpiloi me shkrim këtë:

AKTGJYKIM

(Në bazë të pohimit)

- I. I. VËRTETOHET** se paditësi I.D nga P, është pronar i ngastrës kadastrale me numër P-71611071-05909-3 në sipërfaqe prej 300 m2 në ZK P, e cila ngastër evidentohet në emër të S.L nga K-P, rr”...” nr..., ashtu që **DETYROHET** i padituri S.L nga K-P, rr”.....” nr....., që paditësit I.D nga P, t’ia njih të drejtën e pronësisë mbi këtë paluajtshmëri dhe të lejoj që të njëjtën ta regjistroj në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri pranë Zyrës Komunale Kadastrale në P, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimeve e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë Gjykatës Themelore në Pejë me dt. 08.12.2021, ka ushtruar padi kundër të paditurit me bazë juridike vërtetim pronësie, me të cilën ka kërkuar që të **VËRTETOHET** se paditësi I.D nga P, është pronar i ngastrës kadastrale me numër P-71611071-05909-3 në sipërfaqe prej 300 m2 në ZK P, e cila ngastër evidentohet në emër të S.L nga K-P, rr”.....” nr....., ashtu që **DETYROHET** i padituri S.L nga K-P, rr ”.....” nr.... që paditësit I.D nga P, t’ia njih të drejtën e pronësisë mbi këtë paluajtshmëri dhe të lejoj që të njëjtën ta regjistroj në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri pranë Zyrës Komunale Kadastrale në P.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me dt. 28.12.2023, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbesim në tersi pranë padisë dhe kërkesë së saj, dhe meqenëse kjo çështje juridiko-civile është pohuar nga ana e paditësit, i propozojmë gjykatës që të bie aktgjykim në bazë të pohimit.

Ndërsa paditësi në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar mbes ne tersi pranë përgjigje ne padi duke i pohuar faktet dhe rrethanat pasi qe është vërtetë se këtë paluajtshmeri e ka blerë paditësi, dhe që nga ajo kohe e ka në posedim të qetë dhe të lirë, andaj dhe i propozojmë gjykatës që të bie aktgjykim në bazë të pohimit.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike me ekspertin e Gjeodezisë Sh. K ka dalur në teren për të ber identifikimin e ngastrës kadastrale P-71611071-05909-3 në sipërfaqe prej 300 m2 në ZK P, ku e njëjta në teren shfrytëzohet nga pala paditësi ku në këtë ngastër ka te ndërtuar edhe një objekt B+p+1K+NK.

Duke pasur parasysh faktin se pala e paditur e ka pohuar në tërësi kërkesëpadinë e palës paditëse dhe në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesa për të cilat palët mund të disponojnë lirisht, dhe se nuk ka pengesa në kuptim të nenit 3.3, të LPK-së, gjykata pa shqyrtim të mëtejme e në kuptim të nenit 148, të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata nuk vendosi, meqë asnjëra nga palët nuk i ka kërkuar e në kuptim të nenit 463.1, të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:275939 - C. nr. 2825/21, 05.01.2024

Gjyqtari
Besnik Shala

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit te të njëjtit në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.